



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 13237 prot.

Vlorë më 21/11/2022

PROJEKT-VENDIM
PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT
BASHKIAK VLORE PËR PERIUdhËN JANAR 2023 – DHJETOR 2023

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, dhe sipas relacionit të Këshillit, Këshillit Bashkiak ,

VENDOSI

1. Miratimin e programit të punës së Këshillit Bashkiak Vlorë për periudhën Janar 2023 – dhjetor 2023, bashkëngjitur këtij vendimi .
2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Vlorë dhe Kryetari Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARE

Migena Balla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

NR/3237/Prot

Vlorë, më 21.11.2022

RELACION

“Për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Bashkiak”

Baza ligjore: Ligji 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 7, neni 16, 18, 54, Ligji 69/2018 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, neni 6, neni 41, Ligji 146/2014 për Konsultimin Publik”, Udhëzimi nr.23, datë 30.10.2018 “Për përgatitjen e Projekt buxhetit afatmesëm”, Rregullore e Organizimit dhe funksionimit, Rregullores së marrëdhënies së publikut me median dhe konsultimeve publike, Rregullores së strukturave komunitare.

Të nderuar Keshilltarë!

Plani i punës së Këshillit është njëdokument tepër i rëndësishëm për të zbatuar sa më mirë ligjin, udhëzimet dhe rregulloret përkatëse, por mbi të gjitha për të marrë vendime sa më të drejta për qytetarët.

Plani i punës ka në përbërjen e vet një plan aktiviteteve mujore bazuar kjo në Ligjet e sipërpërmendur, Rregullore, Dokumente strategjike të Bashkisë, Planine përgjithshëm Vendor, Planin Social, Planine Integritetit etj. si dhe eksperiencat e viteve të mëparshme. Në muaj të ndryshëm janë parashikuar edhe tema të rëndësishme sic janë: Tema mbi klimen, mbi Mjedisin, fushata ndërgjegjësuere në bashkëpunim me këshillat rinorë, informacione të ndryshme nga Drejtoritë e bashkisë etj.

Gjithashtu plani i Punës ka në përbërjen e vet një plan konsultimi me publikun, bazuar në ligjin për Konsultimin publik dhe Rregulloren e Këshillit për konsultimet publike. Neni 16 dhe 18 i Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” detyron Këshillin bashkiak të organizojë Konsultime publike për vendimet që merr, kur bëhet fjalë për buxhetin, ndryshimet përkatëse, pikat “a”, “dh”, “e”, “f”, dhe “k” dhe Rregullorja e Këshillit shpjegon procedurën se si duhet të ndodh ky konsultim. Ndaj është përgatitur një Plan i detajuar i shoqëruar me shpenzimet përkatëse.

Për të bërë të realizueshëm këtë plan, patjetër që është e nevojshme dhe mbështetja financiare dhe kjo është bërë nëpërmjet buxhetit të Këshillit, i bazuar në ligjin 139, dhe gjithashtu në udhëzimin për përgatitjen e buxhetit afatmesëm.

me këtë Buxhet futen Pagat e Sekretariatit (sekretarit), Shperblimet e Këshilltarëve, shpërblimet për Kryetarët e Fshatrave, shpenzime për realizimin e Konsultimeve publike. Shpenzime për ujë në sallën e mbledhjeve apo shpenzime për trajnime apo kualifikimin profesional të Këshilltarëve bazuar edhe kjo në ligj. Një zë të vecantë zë edhe trajnimi i këshilltarëve të rinj me bashkëfinacim me projekte vendase ose të huaja.

Këshilli Bashkiak si një Organ Kushtetuesi pavarur, vendimarrës, përfaqësues i Komunitetit, nuk mund të ushtrojë rolin e tij pa këtë dokument të rëndësishëm. Plani duhet të shihet me vëmendja nga Komisionet dhe nga drejtoritë që ta zbatojnë sa më korrekt duke mundësuar dhe prurjen e materialeve në kohë dhe në afatin e përcaktuar. Natyrisht ky Plan merr parasysh dinamikën e aktivitete në komunitet dhe mund të jetë subjekt rishikimi. Këto ndryshime duhet të jenë të arsyetura dhe të domosdoshme pa cënuar mbarëvajtjen e punës së Këshillit.

Kryetare

MIGENA BALLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1323 Prot.,

Vlorë, më 21.11.2022

PLANI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2023

| Muaji | Aktivitete të planifikuara | Autoriteti përgjegjës | Referenca ligjore dhe dokumente të tjera |
|-------|----------------------------|-----------------------|--|
|-------|----------------------------|-----------------------|--|

| | | | |
|---------------------------|---|---|--|
| <p>J A N A R</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të Këshillit Bashkiak -Mbledhja e Këshillit (1) <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 1-Performanca dhe problematikat e punës së drejtorisë së mbrojtjes së territorit gjatë vitit 2022. 2-Miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. 3-Raport mbi veprimtarinë e keshillit për vitin 2022. 4-Seance informuese mbi ndryshimet klimaterike dhe situatat mjedisore ne territorin e bashkisë. | <ul style="list-style-type: none"> - K. B - Sekretari - Zyrat përkatëse të administratës së bashkisë. | <p>Ligji 139/2015</p> |
| <p>S H K U R T</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të këshillit sipas tematikës së mbledhjes. -Mbledhja e Këshillit (1) - Konsultime me komunitetin per ceshtje per qesipastlgljikanenevoje per konsultimshitje, blejje e dhenje me gera, norma e standartetesherbimevepubllikedhefukSIONeveletjeraligjore <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. 2-Raport mbi performancën e punës së zyrës së | <p>K. B</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sekretari -Komision ekonomi, finan cë, buxhet. -Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015 -Ligji 68/2018 -Rregulloret e këshillit bashkiak |

| | | | |
|-----------------------------------|---|---|---|
| | <p>emergjencave civile.</p> | | |
| <p>M A R S</p> | <p>➤ <i>Veprimtarite:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të keshillit bashkiak sipas tematikës së mbledhjes . -Mbledhja e Këshillit.(1) <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Miratimi i buxhetit faktik i vitit 2021. 2-Raport mbi situatën dhe problematikatë sektorit të bujqësisë, bordit të kullimit si dhe situata e administrimit të pyje ve dhe kullota. 3-Miratimi i tavanave përgatitore të shpenzimeve për çdo program buxhetor. 4-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushhtëzuar. | <p>-K. B -Sekretari -Komisioni i ekonomisë financës, buxhet et -komisioni i çështjeve juridike,rendit publik dhe mbrojtjes civile. -zyra e ndihmës sociale.</p> | <p>-Ligji 139/2015 -Ligji 68/2015</p> |

| | | | |
|---|--|--|---|
| <p>P R I L L</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të keshillit bashkiak. -Mbledhja e Këshillit.(1) <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 1-Performanca e sektorit të pastirimit si dhe të sektorit të ndriçimit. 2-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. 3-Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve që i janë drejtuar keshillit bashkiak. 4- Fushata ndergjegjesuese te keshillit bashkiak ne bashkepunim me keshillat rinor. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë dhe financës. -Strukturat përkatëse të administratës. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015 -Vendimet përkatëse të keshillit bashkiak. |
| <p>M A J</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e Komisioneve të keshillit bashkiak -Mbledhja e Këshillit.(1) <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 1-Analizë e raportit të 4-mujorit të veprimtarisë financiare të Bashkisë. 2-Raport mbi treguesit e performancës për 4-mujorin e parë të drejtorisë së shërbimeve publike. 3-Informacion mbi masat e marra për mbrojtjen nga zjarret nga MSZH-ja dhe mbi masat e marra për çeljen e sezonit turistik. 4-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë dhe financës. -Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore” -Vendimet e Këshillit Bashkiak. |

| | | | |
|-----------------------------|---|---|---|
| <p>Q E R S H O R</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Tematika e muqit:</i> 1-Konstituimi i këshillit të bashkiak dhe bejimi i kryetarit të bashkisë. 2-Miratimi i draftit të PBA-së dhe rekomandimeve. 3-Raport mbi problematikat e arsimit parashkollor në institucionet e arsimit parashkollor të bashkisë. 4-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë dhe financës. -Strukturat përkatëse të administratës së bashkië. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" -VKB Buxheti |
| <p>K O R R I K</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit . <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Tematika e muqit.</i> 1-Miratimi i Tavanave përfundimtare të shpenzimeve të PBA në nivel programi. 2-Raport mbi performancën e drejtorisë së Mbrojtjes së territorit. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. 4- Zgjedhjet e Anetareve të Këshillit të Qarkut | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë dhe financës. -Komisioni i arsimit kulturës dhe shëndetit. -Strukturat e administratës së bashkisë. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". |

| | | | |
|-----------------------------|---|--|--|
| <p>G U S H T</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të kështillit. -Mbledhja e kështillit. <p>➤ <i>Tematika e muqjit:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Analizë e komisionit të barazisë gjimore dhe problematikave sociale. 2-Raport mbi performancën e drejtorisë së zhvillimit dhe planifikimit të Territorit. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i barazisë gjimore . -Strukturat e administratës së bashkisë. | <p>-Ligji 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore'.</p> |
| <p>S H T A T O R</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të kështillit -Mbledhja e kështillit -Dëgjesa publike për PBA-në -Trajnimet për kështillaret e rinj në bashkëpunim me BtF. <p>➤ <i>Tematika e muqjit:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Analizë e raportit të 4-mujorit të dytë mbi realizimin e të ardhurave të bashkisë. 2-Raport mbi masat e marra për fillimin e vitit të ri arsimor. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë, financës dhe buxhetit. -Komisioni i arsimit, kulturës. -Strukturat e administratës së bashkisë -KB -Sekretari -Komisioni i zhvillimit urban, shërbimeve dhe strehimit. -Strukturat përkatëse të | <p>Ligji 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore'</p> <p>Ligji 146/2014, 'Për njoftimin dhe konsultimin publik'.</p> <p>-Ligji</p> |

| | | | |
|---------------------------|---|---|---|
| <p>E T O R</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të këshillit.</p> <p>-Mbledhja e këshillit.</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Raport mbi performancën e punës së drejtorisë së bujqësisë, shërbimit veterinar, kullimit si dhe pyje kullotave.</p> <p>2-Raport mbi ecurinë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022.</p> <p>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar.</p> | <p>administratës së bashkisë.</p> | <p>139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". VKB për buxhetin 2021.</p> |
| <p>N E N T O R</p> | <p>➤ <i>Veprimtaritë:</i></p> <p>-Mbledhja e komisioneve të këshillit.</p> <p>-Mbledhja e këshillit.</p> <p>Konsultime publike për buxhetin 2024.</p> <p>➤ <i>Tematika e muajit:</i></p> <p>1-Miratimi i paketës fiskale e vitit 2024.</p> <p>2-Problematikat në lidhje me shërbimet publike si dhe masat për përmirësimin e këtij shërbimi.</p> <p>3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar.</p> | <p>-KB -Të gjitha komisionet e këshillit. -Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë.</p> | <p>-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Ligji 146/2014, "për njoftim dhe konsultim publik".</p> |

| | | | |
|-------------------------------|--|--|--|
| <p>D H H J E T O R</p> | <p>➤ <i>Veprimtarië:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Mbledhja e komisioneve të keshillit -Mbledhja e keshillit <p>➤ <i>Tematika e muajit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 1-Diskutime për raportin e treguesve financiar për 4-mujorin e tretë. 2-Miratimi i buxhetit të vitit 2024 si edhe PBA-se. 3-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i pakushtëzuar. | <ul style="list-style-type: none"> -KB -Të gjitha komisionet -Të gjitha strukturat e administratës së bashkisë. | <ul style="list-style-type: none"> -Ligji 139/2015, "Për veteqeverisjen vendore". -Ligji 68/2017 |
|-------------------------------|--|--|--|

Sqarim: Në këtë plan aktivitetesh nuk janë përfshirë çeshtje të ndryshme që mund të vijnë nga administrata e bashkisë, përfshirë dhe ndryshimet e buxhetit. Gjithashtu çdo anëtar i keshillit rezervon të drejtëngjë gjatë vitit të përfshijë tematika dhe çeshtje të ndryshme të cilat ai/ajo mendon se ndikon në pëmirësimin e treguesve të performancës së administratës së bashkisë dhe të keshillit në shërbim të komunitetit.

KRYETARE E KESHILLIT
MIGENA BALLA

